



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 16817 prot.

Shkodër, më 30.06.2026

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe të rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Shkodër", miratuar me Vendimin nr. 60, datë 28.12.2020, njoftoj thirrjen e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, ditën e martë, datë 30.06.2026, ora 17:00, me rend dite si më poshtë:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, datë 28.05.2026, sipas ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 16, pika 2.

1. *Projektvendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin maj 2026".*
2. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
3. *Projektvendim: "Për miratimin e subjekteve që kërkojnë të njihen si 'Posedues Jopronarë' dhe të planrilevimeve të sipërfaqeve përkatëse në zonat e zhvillimit në territorin e Bashkisë Shkodër".*
4. *Projektvendim: "Për miratimin e kërkesës për transferimin e sipërfaqes prej 200 m² të pasurisë së shoqërisë 'Tregu i Shitjes me Shumicë Fruta-Perime' sh.a. te Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural".*
5. *Projektvendim: "Për miratimin e dhënies së pëlqimit për nënshkrimin e marrëveshjes së investimit për rikonstruksionin e terreneve sportive në kompleksin "Zmijanej", në bashkëpunim me FSHF-në".*

6. *Projektvendim: "Për miratimin e shtesës dhe ndryshimit në buxhetin e Bashkisë Shkodër, miratuar me VKB nr. 84, datë 18.12.2025, 'Për miratimin e buxhetit të vitit 2026 dhe të programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2026–2028', i ndryshuar".*
 7. *Projektvendim: "Për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parashkollor në Bashkinë Shkodër".*
 8. *Projektvendim: "Për miratimin e planit të përmirësimit të shërbimit për arsimin parauniversitar në Bashkinë Shkodër".*
 9. *Projektvendim: "Për miratimin e buxhetit të vitit 2027 dhe të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Shkodër, faza e parë".*
- *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Grafiku i mbledhjeve të komisioneve

Nr.	Komisionet	Dita	Data	Ora
1.	Komisioni i Shërbimeve Sociale dhe Strehimit / Komisioni i Rendit Publik dhe Mbrojtjes Civile	E Enjte	25.06.2026	10:30
2.	Komisioni për Çështjet Ligjore	E Enjte	25.06.2026	11:00
3.	Komisioni i Financave, Buxhetit dhe Aseteve Publike / Komisioni i Kontrollit Financiar	E Enjte	25.06.2026	11:30
4.	Komisioni i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	E Enjte	25.06.2026	12:00
5.	Komisioni i Arsimit	E Enjte	25.06.2026	12:30

Duke ju falënderuar,

KRYETAR

Oltion L. Leli

